



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM

Datë 20.12.2021

PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SARANDË

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 5 dhe 6, të Rregullores “Mbi Kriteret dhe Procedurën e Transferimit të Përkohshëm të Prokurorit”, si dhe në Vendimin Nr. 406, datë 17.12.2021 të KLP-së, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall sot thirrjen për fillimin e procedurave për plotësimin e një vakance, nëpërmjet procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim, si më poshtë:

- ❖ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë për një periudhë 1 vjeçare.

Kriteret e transferimit të përkohshëm me pëlqim janë:

- a) Transferimi i përkohshëm i prokurorit nuk duhet të cenojë funksionimin e Prokurorisë ku kandidati ka caktimin e përhershëm;
- b) Dobia e transferimit të përkohshëm duhet të jetë më e madhe se efekti negativ që shkakton në Prokurorinë ku prokurori ka caktimin e përhershëm;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë i transferuar përkohësisht ose duke shërbyer në skemë delegimi;
- d) Kandidati nuk duhet të jetë nën efektet e një mase disiplinore si dhe të mos ketë procedim disiplinor në proces;
- e) Kandidati nuk duhet të gjendet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

Rruga “Ana Komnena”, Godina ”Poli i Drejtësisë”, Tiranë, Shqipëri

www.klp.al adresa e mail; info@klp.al

Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë janë:

a) prokurorët pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;

Kandidatët që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura i paraqesin kërkesat e tyre jo më vonë se data **23.12.2022**, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në momentin e aplikimit kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë;
- b) Jetëshkrimin e përditësuar, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopjen e kartës së identitetit;
- d) Vetë deklarin për mospasjen masë disiplinore në fuqi;
- e) Vetë deklarin për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Aplikimet do të dorëzohen në formë elektronike në adresën: karriera@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentet e sipërpërmendura duhet të jenë të skanuara) ose në formë fizike në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, godina e “Polit të Drejtësisë”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.